



EHEAROME2020

Komunikata Ministore Romë

SHTOJCA II



EUROPEAN
Higher Education Area



bologna
process



ITALIAN **BFUG** SECRETARIAT
2018-2020



Translated within the Erasmus+ project “[IN-GLOBAL Enhancing Knowledge of the EHEA and Global Dialogue](#)” in 2023.

The original version of the Rome Communiqué and its annexes are available on the website of the European Higher Education Area:

<https://ehea.info/page-ministerial-conference-rome-2020>



**Co-funded by
the European Union**

Funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or the European Education and Culture Executive Agency (EACEA). Neither the European Union nor EACEA can be held responsible for them.

Parimet dhe Udhëzimet për Forcimin e Dimensionit Social në Arsimin e Lartë të ZEAL

Përgatitur nga Grupi Këshillues 1 për Dimensionin Social i BFUG

Prezantimi

Komunikata e Parisit 2018 njohu nevojën për të udhëzuar shtetet anëtare se si të përcaktojnë dhe zbatojnë politikën për përmirësimin e dimensionit social të ZEAL. Ky dokument përshkruan parimet dhe udhëzimet thelbësore, të cilat ne besojmë se janë kryesore për zhvillimin e mëtejshëm të dimensionit social në arsimin e lartë. Ky dokument merr si pikënisje përkufizimin e dimensionit social të dhënë në Komunikatën e Londrës 2007, përkatësisht që përbërja e trupit studentor që fillon, studion dhe përfundon arsimin e lartë në të gjitha nivelet duhet të korrespondojë me profilin heterogjen social të shoqërisë në përgjithësi në vendet e ZEAL. Grupi Këshillues për Dimensionin Social gjithashtu shkon përtej përkufizimit të lartpërmendur dhe e ka zgjeruar përkufizimin duke theksuar se dimensionin social përfshin krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës në arsimin e lartë që nxit barazinë, diversitetin, dhe i përgjigjet nevojave të komuniteteve lokale.

Parimet dhe udhëzimet në brendësi të këtij dokumenti plotësojnë strategjinë ZEAL 2020 “Zgjerimi i pjesëmarrjes për barazi dhe rritje”, të cilin ministrat e miratuan në Jerevan në 2015 si një mënyrë për të forcuar më tej dimensionin social duke kontribuar njëkohësisht në rritjen e cilësisë në arsimin e lartë. Dimensionin social duhet të ndërlihdë parimet e pranimit, barazisë, diversitetit dhe përfshirjes në të gjitha ligjet, politikat dhe praktikën në lidhje me arsimin e lartë në atë mënyrë që pranimi, pjesëmarrja, përparimi dhe përfundimi i arsimit të lartë të varet kryesisht në aftësitë e studentëve, jo në karakteristikat e tyre personale apo rrethanat përtej ndikimit të tyre të drejtpërdrejtë. Me këtë qëllim në mëndje, autoritetet publike duhet të mbështesin zbatimin e këtyre Parimeve dhe Udhëzimeve duke ofruar një kuadër ligjor, financiar, administrativ dhe informues të cilat ofrojnë mbështetje specifike për studentët në nevojë, të pafavorizuar dhe të nënpërfaqësuar. Ky kuadër do të promovojë strategji gjithëpërfshirëse, të cilat ofrojnë mbështetje specifike për studentët e pambrojtur, të pafavorizuar dhe të nënpërfaqësuar² si dhe do të nënvizojë masat dhe politikën më të gjera nga të cilat do të përfitojnë reciprokisht popullata/komuniteti studentor/e dhe personeli i punësuar në institucionet e arsimit të lartë.

Rritja e pjesëmarrjes së grupeve vulnerabël, të pafavorizuara dhe të nënpërfaqësuar në arsimin e lartë prodhon përfitime më të gjera përse i përket uljes së ofrimit të mirëqenies sociale, përmirësimit të rezultateve shëndetësore dhe rritjes së përfshirjes së komunitetit. Së bashku, këto përfitime më të gjera mbështesin shoqëritë kohezeve dhe demokratike ku mbizotëron drejtësia sociale, e mira publike, përgjegjësia publike dhe mobiliteti social. Kualifikimet e të diplomuarve të shpërndara në një grup më të gjerë qytetarësh do të thotë perspektiva më të mira punësimi, nivele më të larta të të ardhurave dhe përcjelljen e vlerësimit për përfitimet e arsimit të lartë për brezin e ardhshëm dhe për komunitetet e tyre.

Përtej arritjes së angazhimeve të marra nga ZEAL, një qasje gjithëpërfshirëse dhe proaktive për përmirësimin e dimensionit social të arsimit të lartë shërben më tej për të përshpejtuar progresin në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së.

Këto Parime dhe Udhëzime përcaktojnë kursin për dekadën e ardhshme të ZEAL për autoritetet publike dhe institucionet e arsimit të lartë për të integruar këto parime në misionet thelbësore të arsimit të lartë: nxënia dhe mësimdhënia, kërkimi, inovacioni, shkëmbimi dhe shtrirja e njohurive, qeverisja dhe menaxhimi institucional, si dhe

¹ Të aksesueshme në http://www.ehea.info/media/ehea.info/file/2015_Yerevan/71/5/Widening_Participation_for_Equity_and_Growth_A_Strategy_for_the_Development_of_the_SD_and_LLL_in_the_EHEA_to_2020_613715.pdf

² Fjalori i termave dhe përkufizimeve në lidhje me përkufizimet për studentët e cenueshëm, të pafavorizuar dhe të nënpërfaqësuar është në fund të këtij dokumenti

në politikat për fuqizimin e studentëve dhe stafit të arsimit të lartë aktual dhe të ardhshëm. Përmirësimi i dimensionit social duke lëvizur përtej zgjerimit të klauzolave të aksesueshmërisë dhe në vend të kësaj duke u fokusuar në konceptin e “të mos lënit askënd prapa” është një hap i rëndësishëm përpara kur synojmë të forcojmë shoqëritë dhe demokracitë tona. Mbështetja e mjediseve të larmishme të mësimi është një domosdoshmëri dhe duhet parë si një investim për shoqëritë, ndaj autoritetet publike duhet të mbajnë përgjegjësinë për të siguruar që parimet dhe udhëzimet e propozuara të konsultohen, të përshtaten me realitetet kombëtare dhe të zbatohen, në mënyrë që të sigurojmë një të ardhme më të mirë për sistemet tona të arsimit të lartë.

Parimet në tekstin e mëposhtëm duhet të kuptohen si deklarata të nivelit të lartë që shërbejnë si bazë për konceptualizimin e politikave të ndryshme për rritjen e dimensionit social. Udhëzimet janë rekomandime që synojnë të këshillojnë politikbërësit se si duhet të zbatohen parimet në praktikë. Prandaj, tërësia e këtij dokumenti nuk mund të shihet si një listë kontrolli, por më tepër si bazë për përmirësimin e vazhdueshëm të politikave dhe zbatimin efektiv të tyre në nivel kombëtar dhe institucional.

Parimet

- 1. Dimensioi social duhet të jetë qendror për strategjitë e arsimit të lartë në nivel sistemi dhe institucional, si dhe në nivelet e ZEAL dhe BE-së.** Forcimi i dimensionit social të arsimit të lartë dhe nxitja e barazisë dhe përfshirjes për të pasqyruar diversitetin e shoqërisë është përgjegjësi e një sistemi të arsimit të lartë në tërësi dhe duhet të konsiderohet si një angazhim i vazhdueshëm.

Udhëzime:

Angazhimi strategjik ndaj dimensionit social të arsimit të lartë duhet të përafrohet me objektiva konkrete që ose mund të integrohen në politikat ekzistuese të arsimit të lartë ose të zhvillohen paralelisht. Këto objektiva duhet të synojnë zgjerimin e aksesit, mbështetjen e pjesëmarrjes dhe përfundimit të studimeve për të gjithë studentët e sotëm dhe të ardhshëm.

Në procesin e krijimit të strategjive duhet të ketë një dialog me bazë të gjerë ndërmjet autoriteteve publike, institucioneve të arsimit të lartë, përfaqësuesve të studentëve dhe stafit dhe aktorëve të tjerë kryesorë, duke përfshirë partnerët socialë, organizatat joqeveritare dhe njerëzit nga grupet e cënueshme, të pafavorizuara dhe të nënpërfaqësuar. Ky dialog me bazë të gjerë synon të sigurojë krijimin e strategjive gjithëpërfshirëse të arsimit të lartë që nxisin barazinë dhe diversitetin, dhe u përgjigjen nevojave të komunitetit më të gjerë.

- 2. Kornizat ligjore ose dokumentet e politikave duhet të lejojnë dhe të mundësojnë zhvillimin e strategjive nga vetë institucionet e arsimit të lartë për të përmbushur përgjegjësinë e tyre publike drejt zgjerimit të aksesit, pjesëmarrjes në dhe përfundimin e studimeve të arsimit të lartë.**

Udhëzime:

Kornizat ligjore dhe rregullat administrative duhet të lejojnë fleksibilitet të mjaftueshëm në përcaktimin, organizimin dhe ofrimin e programeve të studimit për të pasqyruar shumëllojshmërinë e nevojave të studentëve. Institucionet e arsimit të lartë duhet të mundësojnë organizimin e studimeve me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, mënyra studimi fleksibël, mësim të përzier dhe në distancë si dhe njohjen e studimeve të mëparshme (NJSM), në mënyrë që të akomodohen nevojat e komuniteteve të ndryshme të studentëve.

Autoritetet publike duhet të promovojnë njohjen e studimeve të mëparshme joformale dhe informale (NJSM) në arsimin e lartë, pasi kjo ka një ndikim pozitiv në zgjerimin e aksesit, tranzicionit dhe përfundimit, barazisë dhe përfshirjes, lëvizshmërisë dhe punësimit. NJSM mundëson mënyra fleksibël të të mësuarit gjatë gjithë jetës në të gjithë sektorin e arsimit, duke përfshirë arsimin e lartë. Zbatimi i NJSM do të kërkojë bashkëpunim efektiv midis sistemit të arsimit të lartë, punëdhënësve dhe komunitetit në tërësi dhe për të mundësuar që këto korniza kombëtare të kualifikimeve të lehtësojnë njohjen transparente të rezultateve të të nxëniet dhe procedurat e besueshme të sigurimit të cilësisë.

3. Përmirësimi i gjithëpërfshirjes së sistemit arsimor duke zhvilluar politika koherente nga edukimi në parashkollor, përmes shkollimit deri në arsimin e lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Udhëzime:

Është e rëndësishme krijimi i sinergjisë në të gjitha nivelet e arsimit dhe fushat e lidhura me politikën (si financat, punësimi, shëndeti dhe mirëqenia sociale, strehimi, migrimi etj.) me qëllim zhvillimin e masave politike që krijojnë një mjedis gjithëpërfshirës në të gjithë sektorin e arsimit që nxit barazinë, diversitetin dhe përfshirjen, dhe i përgjigjet nevojave të gjithë komunitetit.

Politikat e dimensionit social nuk duhet të mbështesin vetëm studentët aktualë, por edhe studentët potencialë në përgatitjen dhe kalimin e tyre në arsimin e lartë. Pjesëmarrja në arsimin e lartë duhet të jetë një opsion gjatë gjithë jetës, duke përfshirë të rriturit që vendosin të kthehen ose të hyjnë në arsimin e lartë në fazat e mëvonshme të jetës së tyre. Një qasje përfshirëse duhet të përfshijë tërë komunitetin, institucionet e arsimit të lartë dhe grupet e tjera të palëve të interesuara për të bashkë-krijuar rrugë drejt arsimit të lartë.

Barazia, diversiteti dhe përfshirja duhet të luajnë një rol kyç në trajnimin e mësuesve të arsimit parauniversitar.

4. Të dhënat e besueshme janë një parakusht i domosdoshëm për një përmirësim të bazuar në fakte për dimensionin social në arsimin e lartë. Sistemet e arsimit të lartë duhet të përcaktojnë pikësynimin dhe objektivat e grumbullimit të llojeve të caktuara të të dhënave, duke marrë parasysh veçoritë e kuadrit ligjor kombëtar. Duhet zhvilluar kapacitete të mjaftueshme për të mbledhur, përpunuar dhe përdorur të dhëna të tilla për të informuar dhe mbështetur dimensionin social të arsimit të lartë.

Udhëzime:

Për të zhvilluar politika efektive, është e nevojshme mbledhja e vazhdueshme e të dhënave kombëtare. Një mbledhje e tillë e të dhënave duhet të sigurojë informacion mbi përbërjen e trupës studentore, aksesin dhe pjesëmarrjen, braktisjen dhe përfundimin e arsimit të lartë, brenda kufijve të kornizave ligjore kombëtare, duke përfshirë kalimin në tregun e punës pas përfundimit të studimeve, dhe të lejojë identifikimin e personave të cënueshëm, të pafavorizuar dhe grupet e nënpërfaqësuar.

Për ta bërë mbledhjen e të dhënave të tilla të krahasueshme ndërkombëtarisht, të rëndësishme për dimensionin social, duhet zhvilluar puna në kategorinë administrative të mbledhjes së të dhënave në nivel ZEAL, përmes Eurostudent ose sondazheve të ngjashme. Me qëllim racionalizimin e procesit dhe shmangies së barrës administrative për administratën publike dhe institucionet e arsimit të lartë, ky zhvillim duhet të marrë parasysh ekzistimin e praktikave kombëtare dhe proceseve përkatëse të mbledhjes së të dhënave.

Këto ushtrime kombëtare për mbledhjen e të dhënave mund të plotësohen, aty ku është e domosdoshme dhe e nevojshme, me ndërmarjen e sondazheve në institucionet e arsimit të lartë, kërkime dhe analiza për të kuptuar më mirë cënueshmërinë, disavantazhet, dhe nënpërfaqësimin në arsim, si dhe tranzicionin e studentëve në sistemin arsimor.

- 5. Autoritetet publike duhet të kenë politika që u mundësojnë institucioneve të arsimit të lartë të sigurojnë këshillim dhe udhëzim efektiv për studentët potencialë dhe të regjistruar në mënyrë që të zgjerohet akses i tyre në pjesëmarrje dhe në përfundimin e studimeve të arsimit të lartë.** Këto shërbime duhet të jenë koherente në të gjithë arsimin sistemit, duke pasur parasysh të veçantë kalimet ndërmjet niveleve të ndryshme arsimore, institucioneve arsimore dhe në tregun e punës.

Udhëzime:

Autoritetet publike duhet të krijojnë kushte që mundësojnë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të ndryshme publike që ofrojnë shërbime këshillimi dhe orientimi së bashku me institucionet e arsimit të lartë për të krijuar sinergjitë dhe shmangien e dyfishimit të shërbimeve të ngjashme. Këto shërbime duhet të respektojnë parimet e qartësisë dhe të jenë miqësore ndaj përdoruesit, pasi përdoruesit duhet të jenë të aftë t'i kuptojnë ato lehtësisht.

Brenda një trupe studentore të larmishme, vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet studentëve me aftësi ndryshe të shëndetit fizik dhe psikologjik. Këta studentë duhet të kenë qasje në mbështetje profesionale për të siguruar mbështetjen e tyre në aksesin dhe përfundimin e studimeve të arsimit të lartë. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet parandalimit të aftësive ndryshe psikologjike të shkaktuara nga organizimi i studimeve dhe kushtet e jetesës së studentëve.

Autoritetet publike duhet të konsiderojnë gjithashtu ngritjen e institucioneve të tipit avokati i popullit/ ombudsperson që do të kenë kapacitete dhe njohuri për të ndërmjetësuar çdo konflikt, veçanërisht në lidhje me çështjet e barazive të njëjta që mund të lindin gjatë aksesit ose pjesëmarrjes në arsimin e lartë, ose konflikte që pengojnë përfundimin e studimeve.

- 6. Autoritetet publike duhet të sigurojnë financim të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm dhe autonomi financiare për institucionet e arsimit të lartë duke u mundësuar atyre të ndërtojnë kapacitetet e duhura për të përfaquar diversitetin dhe për të kontribuar në barazinë dhe përfshirjen në arsimin e lartë.**

Udhëzime:

Sistemet e financimit të arsimit të lartë duhet të lehtësojnë arritjen e objektivave strategjike që lidhen me dimensionin social të arsimit të lartë. Institucionet e arsimit të lartë duhet të mbështeten dhe të shpërblehen në përmbushjen e objektivave të dakordësuara për zgjerimin e aksesit, rritjen e pjesëmarrjes dhe përfundimin e studimeve të arsimit të lartë, veçanërisht në lidhje me grupet e cënueshme, të pafavorizuara dhe të nënpërfaqësuar. Mekanizmat për arritjen e këtyre objektivave nuk duhet të ketë pasoja financiare negative për financimin bazë të institucioneve të arsimit të lartë.

Sistemet e mbështetjes financiare duhet të synojnë të jenë universalisht të zbatueshme për të gjithë studentët, megjithatë, kur kjo nuk është e mundur, sistemet publike të mbështetjes financiare të studentëve duhet të bazohen kryesisht në nevoja dhe për të bërë një arsim të lartë të përballueshëm për të gjithë studentët, për të nxitur aksesin dhe ofruar mundësi për suksese në arsimin e lartë. Ato duhet të kontribuojnë kryesisht për të mbuluar kostot direkte të studimit (tarifat dhe materialet e studimit) dhe kostot indirekte (p.sh. akomodimi, i cili po bëhet gjithnjë e më problematik për studentët anembanë ZEAL për shkak të rritjes së kostove të strehimit, jetesës dhe transportit, etj.).

- 7. Autoritetet publike duhet të ndihmojnë institucionet e arsimit të lartë për të forcuar kapacitetin e tyre për t'iu përgjigjur nevojave të një trupe studentore dhe personeli më të larmishëm si dhe për të krijuar mjedise mësimore gjithëpërfshirëse dhe kultura institucionale gjithëpërfshirëse.**

Udhëzime:

Autoritetet publike duhet të mbështesin dhe të ofrojnë mjete adekuate për institucionet e arsimit të lartë për t'iu përmirësuar trajnimin profesional fillestar dhe të vazhdueshëm për personelin akademik dhe administrativ për t'i mundësuar ata të punojnë profesionalisht dhe në mënyrë të barabartë me një ent studentor dhe stafi të ndryshëm.

Kurdoherë që është e mundur, sistemet e jashtme të sigurimit të cilësisë duhet të trajtojnë se si dimensionin social, diversitetin, aksesueshmërinë, barazinë dhe përfshirjen reflektohen brenda misionëve institucionale të institucioneve të arsimit të lartë, duke respektuar parimin e autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë.

- 8. Programet ndërkombëtare të mobilitetit në arsimin e lartë duhet të strukturohen dhe zbatohen në atë mënyrë që të nxisin diversitetin, barazinë dhe përfshirjen dhe duhet të nxisin veçanërisht pjesëmarrjen e studentëve dhe stafit nga prejardhje të cënueshme, të pafavorizuar ose të nënpërfaqësuar.**

Udhëzime:

Përvojat ndërkombëtare përmes mobilitetit mësimor përmirësojnë cilësinë e rezultateve të të nxënësve në arsimin e lartë. Autoritetet publike dhe institucionet e arsimit të lartë duhet të sigurojnë qasje të barabartë për të gjithë në mundësitë e të mësuarit të ofruara nga programet e mobilitetit kombëtare dhe ndërkombëtare të të mësuarit dhe trajnimit si dhe adresojnë në mënyrë aktive pengesat për mobilitet për grupet e cënueshme, të pafavorizuara ose të nënpërfaqësuar të studentëve dhe stafit.

Përveç mbështetjes së mëtejshme për mobilitet fizik, duke përfshirë transportueshmërinë e plotë të granteve dhe huave në të gjithë ZEAL, autoritetet publike dhe institucionet e arsimit të lartë duhet të lehtësojnë përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) për të mbështetur mobilitetin e përzier dhe për të nxitur ndërkombëtarizimin në vend duke përfshirë bashkëpunimin online ndërkombëtar të kurseve. Mobiliteti i përzier është kombinimi i një periudhe të mobilitetit fizik dhe një periudhe mësimi online. Një bashkëpunim i tillë online mund të përdoret për të zgjeruar rezultatet e të nxënësve dhe rritur ndikimin e mobilitetit fizik, për shembull duke bashkuar një grup pjesëmarrësish më të larmishëm, ose duke ofruar një gamë më të gjerë opsionesh mobiliteti.

9. Institucionet e arsimit të lartë duhet të sigurojnë që angazhimi i komunitetit në arsimin e lartë të promovojë diversitet, barazi dhe gjithpërfshirje.

Udhëzime:

Angazhimi i komunitetit duhet të konsiderohet si një proces ku angazhohen institucionet e arsimit të lartë me aktorët e jashtëm të komunitetit për të ndërmarrë aktivitete të përbashkëta që mund të jenë reciprokisht të dobishme. Ashtu si politikat e dimensionit social, angazhimi i komunitetit duhet të përfshihet në misionet thelbësore të arsimit të lartë. Ai duhet të angazhohet me mësimdhënien dhe të nxënit, kërkimin shkencor, shërbimin dhe shkëmbimin e njohurive, studentët dhe stafin si dhe menaxhimin e institucioneve të arsimit të lartë. Një angazhim i tillë ofron një bazë tërësore mbi të cilën universitetet mund të adresojnë një gamë të gjerë nevojash shoqërore, duke përfshirë ato të grupeve të cënueshme, të pafavorizuar dhe nënperfaqësuar, ndërkohë që pasurojnë funksionet e tyre mësimore, kërkimore dhe të tjera thelbësore.

Aktorët e komunitetit (p.sh. autoritetet lokale, organizatat kulturore, organizatat joqeveritare, bizneset, qytetarët) duhet të jenë në gjendje të angazhohen në mënyrë kuptimplote me aktorët e arsimit të lartë përmes hapjes së dialogut. Kjo do të mundësojë partneritete të mirëfillta universitet-komunitet, të cilat mund të trajtojnë në mënyrë efektive sfidat sociale dhe demokratike.

10. Autoritetet publike duhet të angazhohen në një dialog politik me institucionet e arsimit të lartë dhe palët e tjera relevante të interesuara se si parimet dhe udhëzimet e mësipërme mund të përkthehen dhe zbatohen si në sistemin kombëtar ashtu edhe në nivelin institucional.

Udhëzime:

Një dialog i tillë politikash duhet të lejojë zhvillimin e masave të politikave që përshtaten qëllimit, të cilat duhet të respektojnë autonominë institucionale, të shmangin çdo barrë administrative të panevojshme dhe në këtë mënyrë të mundësojnë progres konkret drejt diversitetit, barazisë dhe përfshirjes në arsimin e lartë.

Brenda fushës së parimeve dhe udhëzimeve të mësipërme, mbështetja e kolegëve dhe shkëmbimi i praktikave të mira midis vendeve të ZEAL janë vendimtare për të lehtësuar progresin drejt gjithëpërfshirjes së sistemeve të arsimit të lartë.

Fjalorth i termave dhe përkufizimeve³

Ky fjalorth përcakton tre termat qendrorë në këtë dokument, përkatësisht student të nënpërfaqësuar, të pafavorizuar dhe të pambrojtur. Përkufizimet nuk duhet të kuptohen si përkufizime ligjore dhe për këtë arsye nuk bien ndesh me çdo rregullore ligjore ekzistuese, ato duhet të kuptohen më tepër si përkufizime shpjeguese të përdorura në lidhje me përmbajtjen e Parimeve dhe Udhëzimeve.

Studentët e nënpërfaqësuar:

Një grup studentësh është i nënpërfaqësuar në lidhje me disa karakteristika (p.sh. gjinia, mosha, kombësia, prejardhja gjeografike, prejardhja socio-ekonomike, pakicat etnike) nëse pjesa e tij në mesin e studentëve është më e ulët se pjesa e një grupi të krahasueshëm në popullsinë e përgjithshme. Kjo mund të dokumentohet në kohën e pranimit, gjatë kursit të studimeve ose në diplomim. Zakonisht individët kanë disa karakteristika të nënpërfaqësuar, kjo është edhe arsyeja pse kombinimet e karakteristikave të nënpërfaqësuar ("ndërprerje") duhet të merren gjithmonë parasysh. Për më tepër, nënpërfaqësimi mund të ndikojë gjithashtu në nivele të ndryshme të arsimit të lartë – program studimi, fakultet ose departament, institucioni i arsimit të lartë, sistemi i arsimit të lartë.

Ky përkufizim është plotësues me Komunikatën e Londrës, "që ent/grupii studentor që hyn, merr pjesë dhe përfundon arsimin e lartë në të gjitha nivelet duhet të pasqyrojë diversitetin e popullatave tona", por nuk e mbulon plotësisht atë.

Studentët e pafavorizuar:

Studentët e pafavorizuar shpesh përballen me sfida specifike në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre në arsimin e lartë. Kjo mund të ketë shumë forma (p.sh. paaftësi, të ardhura të ulëta familjare, pak ose aspak mbështetje familjare, jetim, lëvizje në shumë shkolla, shëndeti mendor, shtatzënia, të paturit më pak kohë për të studiuar, sepse duhet siguruar jetesa duke punuar ose duke u përkujdesur). Disavantazhi mund të jetë i përhershëm, mund të ndodhë herë pas here ose vetëm për një periudhë të kufizuar. Studentët e pafavorizuar mund të jenë pjesë e një grupi të nënpërfaqësuar, por nuk duhet të jenë patjetër të tillë. Prandaj, disavantazhi dhe të nënpërfaqësuarit nuk janë sinonime.

Studentët në nevojë:

Studentët vulnerabël mund të jenë në rrezik të disavantazhit (shih më lart) dhe përveç kësaj kanë nevoja të veçanta (mbrojtje). Për shembull, për shkak se vuajnë nga një sëmundje (përfshirë shëndetin mendor) ose kanë aftësi të kufizuara, sepse janë të mitur, sepse leja e tyre e qëndrimit varet nga sukcesi i studimeve të tyre (dhe rrjedhimisht edhe nga vendimet e marra nga mësuesit e veçantë), sepse rrezikohen të diskriminohen. Këta nxënës janë të cenueshëm në kuptimin që ata mund të mos jenë në gjendje të sigurojnë mirëqenien e tyre personale, ose që mund të mos jenë në gjendje të mbrohen nga dëmtimi ose shfrytëzimi dhe kanë nevojë për mbështetje ose vëmendje shtesë.

³ Ky fjalor është menduar vetëm për qëllimin e këtyre Parimeve dhe Udhëzimeve.



**Co-funded by
the European Union**

This translation is co-funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or the European Education and Culture Executive Agency (EACEA). Neither the European Union nor EACEA can be held responsible for them.

